




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-0/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-883/14
Nr. i faq. Broj stranica 02	Data Datum 14.03.2014
Nr. pages	PRISHTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.03.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-256/14 për z.Sali Bashota – Kryetar i Këshillit Drejtues të Biblotekës Kombëtare të Kosovës, për shkak se nuk ka konflikt interesi në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-256-14, për Zyrtarin e lartë, z. Sali Bashota, Kryetar i Këshillit Drejtues të Biblotekës Kombëtare të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Sali Bashota s'pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ai është paraqitur në AKK, me ç'rast është analizuar situata në të cilën ndodhet, si dhe të drejtat, përgjegjësitë dhe kompetencat që dalin nga ushtrimi i funksionit të Anëtarit të Këshillit Drejtues të Biblotekës Kombëtare të Kosovës, gjithnjë në raport me parandalimin ose shmangien eventuale të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Bashota, ka deklaruar se me 16.10.2013 ka ofruar dorëheqje (Nr.prot:5484) nga të qenurit Drejtor i Biblotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës e cila është aprovuar nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (shkresa zyrtare me nr.prot.01B-5484).

Ndërkohë, me Vendim të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit nr.101/2013, me datë 24.12.2013, ztr.Bashota është emruar Anëtar i Këshillit Drejtues të Biblotekës Kombëtare të Kosovës.

Emrimi i ztr.Sali Bashota në funksionin e Anëtarit të Këshillit Drejtues të Biblotekës Kombëtare **nuk është konflikt interesi**, siç pretendohet nga denoncuesi, i cili thirret në nenin 17 të Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Ky nen kufizon zyrtarin e lartë, që një vit pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik të zgjedhet në pozitë udhëheqëse, apo të përfshihet në kontrollin e ndërmarrjeve publike apo private, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtëpërdrejtë të lidhura me mbikqyrjen apo kontrollin e afarizmit të atyre ndërmarrjeve.

Kjo, për faktin se ztr. Bashota, duke qenë si një ish Drejtor i Biblotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, gjatë asaj kohe, në bazë të ligjit, i ka raportuar Sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. D.m.th. Drejtori i Biblotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, atëherë nuk ka pas rol mbikqyrës as kontrollues mbi Këshillin Drejtues, i cili në fakt as nuk ka ekzistuar.

Për më tepër, tashmë me Ligjin e ri për Biblotekat nr.04/L-097 për herë të parë parashihen që të themelohen Këshillat Drejtues të këtyre dy biblotekave, që po me të njejtin ligj, parashihen që të funksionojnë si dy institucione të ndara dhe të pavarura (neni 5 i Ligjit nr.04/L-097). Njëra si Bibloteka Kombëtare e Kosovës dhe tjetra si Bibloteka Qendrore Universitare e Kosovës.

Ztr.Sali Bashota, pastaj është zgjedhur Kryetar i Këshillit Drejtues të Biblotekës Kombëtare të Kosovës.

Ky Këshill ka kompetenca të përcaktuara me Ligjin për Biblotekat (neni 10 i Ligjit Nr.04/L-097). Ndërsa, po me këtë ligj, parashihet që Drejtorët e Biblotekave publike (asaj Kombëtare, Universitare dhe Komunale) të zgjedhen me konkurs, dhe në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të tij parashihet, pos tjerash që; Drejtori për punën e tij i raporton dhe i përgjigjet Këshillit Drejtues (Neni 11, paragrafi 5).

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

